



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:098866
Datë: 29.04.2024
Numri i dokumentit: 05632006

Ac.nr.1903/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Bislimaj, kryetar i kolegjit, Hidajete Gashi Alaj dhe Faton Ademi, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit I. V. nga Ferizaj, Rr. "N. B." p.n., të cilin me autorizim e përfaqëson J.B., avokat nga Ferizaj, kundër të paditurve S. S., A. S., F. S., N. S., N. S., që të gjithë nga Ferizaj, Rr. "Nj. B." si dhe M. B. nga Ferizaj, Rr. "E. e J." dhe N. F. nga Ferizaj, Rr. "R. B.", duke vendosur sipas ankesës së paditësit, paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.738/2018, të datës 03.02.2021, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 22.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e paditësit I. V. nga Ferizaj, PRISHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.738/2018, të datës 03.02.2021 dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e atakuar, C.nr.738/2018, të datës 03.02.2021, ka vendosur si në vijim: I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit I. V. nga Ferizaj, e ushtruar kundër të paditurve: S. S., A. S., F. S., N. S., N. S., M. B. dhe N. F., që të gjithë nga Ferizaj, me të cilën ka kërkuar vërtetimin e të drejtës së pronësisë në parcelë-kadastrale me nr.-2 në sipërfaqe prej m², e cila gjendet në vendin e quajtur "V." Zona Kadastrale Ferizaj, e evidentuar në emër të H. S., si e pa bazuar. II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

Kundër këtij aktvendimi, paditësi brenda afatit ligjor, ka parashtruar ankesë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që Gjykata e Apeli ta aprovoj ankesën e paraqitur si të bazuar ndërsa aktvendimin e ankimuar ta ndryshojë apo ta prish aktgjykimin e ankimuar dhe lëndën t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Të paditurit nuk kanë parashtruar përgjigje në ankesë edhe pse të njëjtët me kohë janë njoftuar me ankesën e paditësit.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e paditësit është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, përmes të autorizuarit të tij, me datë 10.08.2018, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi e të cilën e ka precizuar përmes parashtresës së datës 27.11.2020, kundër të paditurve me objekt kontesti vërtetim pronësie, me pretendimet se i njëjti është posedues faktik i njësisë kadastrale P-.....-0.....-2, me sipërfaqe prejm², në vendin e quajtur V., zona kadastrale Ferizaj, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë së datës 02.08.2018 e regjistruar në emër të H. S.. Këtë pronës paraardhësi i paditësit (babai) i paditësit e kishte blerë nga paraardhësi i të paditurve me anë të kontratës së shitblerjes, të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Ferizaj me shenjën Oy.Br.....3/64, të datës 21.12.1964, mirëpo për shkak të pamundësisë që prona të bartet në emrin e tij për shkak të ndryshimeve në sipërfaqe e cila është bërë nga vet palët, i njëjti pronën nuk ka mundur ta bartë në emrin e tij andaj përmes padisë ka kërkuar që të njëjtit t'i njihet e drejta e pronësisë në bazë të kontratës së shitblerjes së lartë cekur. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor me datë 21.10.2020, administrimit dhe shqyrtimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse, si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktvendim C.nr.738/18, të datës 03.02.2021, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të tij.

Në arsyetim të aktvendimin të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ndër tjera ka arsyetuar se “ nga deklarimi i palëve ndërgjyqëse, dëshmitarëve dhe provave të administruara në këtë procedurë, nga kontrata e shitblerjes VR.nr.1203/1964 e vërtetuar te Gjykata Komunale në Ferizaj më datë 21.12.1964, Gjykata vërtetoi faktin se në mes të shitësit E. S. S. në njërën anë si shitës dhe në mes I. B. V. në njërën anë si blerës kishte ndodhur një raport juridiko civil lidhur me paluajtshmërinë kontestuese në sipërfaqe prej m², ZK. Ferizaj, ku blerësi I.B.V. kishte hyrë në posedim të pronës të cilën ende e ka në posedim dhe shfrytëzim të papenguar nga askush, fakte të cilat janë provuar nga kontrata për shitblerjen e paluajtshmërisë, me nr. reference Oy.Br.1203/64 e datë 21.12.1964, si dhe nga konstatimi i gjendjes faktike në teren përmes ekspertit gjeodet. Nga provat e administruara gjykata ka ardhur në përfundim se paditësi

nuk ka prezantuar asnjë provë të besueshme se paditësi është trashëgimtar i I. B. V. dhe nuk ka sqaruar se a ka edhe trashëgimtarë tjerë, nuk ka prezantuar asnjë provë të besueshme se të paditurit janë trashëgimtar të E.S. S., ka dorëzuar vetëm kontratë e shitblerjes e vërtetuar te Gjykata Komunale në Ferizaj Oy.Br.1203/64 e datë 21.12.1964. Nga kontrata e shitblerjes e vitit 1964 e lidhur në mes të E. S. S. dhe të I. B. V., gjykata vërtetoi faktin se paditësi posedon një titull juridik të vlefshëm për fitimin e të drejtës së pronësisë mbi pronën kontestuese, por se të njëjtën nuk e ka zbatuar në operatin kadastral.

Më tutje ka theksuar se gjykata ka konstatuar se paditësi tashmë e posedon një titull juridik (iustus titulus) siç është kontrata për shitblerjen e paluajtshmërisë, me nr. reference Oy.Br.1203/64 e datë 21.12.1964, e cila është titull juridik i mjaftueshëm për të realizuar të drejtën e tij pronësore dhe atë përmes parashtrimit të kërkesës administrative tek Zyra për Pronë dhe Kadastër në Komunën e Ferizajit, për zbatimin e të njëjtës në librat kadastral. Gjykata ka konstatuar se paditësi në këtë procedurë gjyqësore nuk e ka dëshmuar me asnjë fakt dhe me asnjë provë se ka bërë kërkesë tek organi administrativ ashtu siç e kërkon ligji për zbatimin e këtij titulli ekzekutiv. Pavarësisht deklaramit të paditësit gjatë shqyrtimit gjyqësor se ka bërë kërkesë të tillë, i njëjti nuk ka ofruar ndonjë fakt apo provë se i është mohuar nga organi administrativ e drejta që buron nga titulli juridik (kontrata për shitblerjes e banesës–shtëpisë e vitit 1964) andaj nisur nga ky fakt, gjykata ka konstatuar se të drejtat e pretenduara të paditësit, deri më tani nuk janë vënë në rrezik apo nuk janë shkelur nga askush. Andaj, përderisa ekziston një titull juridik dhe e drejta që buron nga ai titull juridik nuk mohohet apo kundërshtohet nga pala e paditur apo organi administrativ, atëherë nuk ka nevojë që kjo e drejtë të vërtetohet përmes procedurës gjyqësore e në rastin konkret mungon interesi juridik (nevoja për mbrojtje juridike) për vendosje nga gjykata.”

Për mënyrën e vendosjes i është referuar nenit 391, pika e) të LPK-së,

Vendimi për shpenzimet e procedurës e ka zbatuar në nenin 450 të LPK-së.

Pikëpamjet juridike të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata e Apelit tani për tani nuk mund t'i pranojë si të rregullta dhe të ligjshme, për arsye se aktvendimi i atakuar është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika n) i LPK-së, dhe neni 182, paragrafi 1, lidhur me nenin 160 paragrafi 4 të LPK-së dhe nenin 142.3 dhe 391, pika e) të LPK-së, pasi që i njëjti ka të meta që nuk mund të ekzaminohen, dispozitivi dhe arsyetimi i aktgjykimit nuk janë në harmoninë e duhur logjike dhe juridike, ndërsa faktet vendimtare nuk janë vërtetuar dhe arsyetuar si duhet, për çka edhe është bërë vërtetimi jo i plotë i gjendjes faktike, si rezultat i së cilës është bërë edhe zbatimi i gabuar i të drejtës materiale.

Duke ju referuar pretendimeve ankimore të palës paditëse, me rastin e shqyrtimit të aktvendimit të atakuar dhe të gjitha shkresave të lëndës, Gjykata e Apelit ka evidentuar shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat parashihen si shkelje thelbësore, nga neni 182.1, lidhur me nenin 160 dhe neni 182.2, pika (n) i LPK-së, e si pasojë e të cilave, një vendim gjyqësor nuk mund të pranohet asesi, si i drejtë dhe i ligjshëm. Aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë është në kundërshtim edhe me nenin 160.4 të LPK-së, i cili përcakton se: *“Arsyetimi i aktgjykimit përmban kërkesat e palëve, faktet që i kanë parashtruar dhe provat që i kanë propozuar, cilat*

nga faktet e tilla i ka vërtetuar, pse dhe si i ka vërtetuar ato fakte, e po që se i ka vërtetuar me anë të provave, cilat prova i ka shfrytëzuar dhe si i ka vlerësuar ato”. Duke pasur parasysh dispozitat e sipërcituara, Gjykata e Apelit vëren se, arsyetimi i aktvendimit përmban kundërthënie me dispozitivin pasi që përderisa në arsyetim është theksuar se “gjykata vërtetoi faktin se paditësi posedon një titull juridik të vlefshëm për fitimin e të drejtës së pronësisë mbi pronën kontestuese por se të njëjtën nuk e ka zbatuar në operatin kadastral” në dispozitivin ka vendosur që ta refuzojë kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar. Po ashtu kundërthënie në aktvendimin e atakuar është edhe fakti se gjykata e shkallës së parë në njërin anë ka konstatuar se të paditurit nuk e kontestojnë kërkesëpadinë e paditësit për vërtetimin e të drejtës së pronësisë në bazë të blerjes dhe posedimit me mirëbesim por e kontestojnë vetëm në pjesën e ngastrës lëndore që ka të bëjë me sipërfaqen rrugore të kësaj ngastrë e cila është lënë si rrugë, ndërsa në anën tjetër e njëjta ka vendosur që ta refuzojë në tërësi kërkesëpadinë e paditësit për shkak se paditësit i mungon interesi juridik për vendosje nga gjykata. Andaj, në këtë drejtim gjykata e Apelit vëren se paditësi kërkesën e tij e ka precizuar dhe i njëjti kërkon vërtetimin e pronësisë në sipërfaqe prej 450 m2 të ngastrës kadastrale 931-2 e kulturë shtëpi dhe oborr dhe nuk ka kërkuar pjesën që është lënë për rrugë dhe një kërkesë të tillë edhe të paditurit nuk e kanë kundërshtuar.

Po ashtu shkelje të dispozitave procedurale, përkatësisht moszbatim adekuat të tyre, evidentohen që në mënyrën e vendosjes nga gjykata e shkallës së parë e kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë ka vendosur me anë të aktvendimit në lidhje me çështjen kryesore derisa në nenin 142, paragrafi 3 të LPK-së në mënyrë shprehimore është përcaktuar se “Mbi kërkesëpadinë gjykata vendos me aktgjykim, kurse në procedurën sipas padisë për shkak të pengimit të posedimit me aktvendim”. Pra, gjykata vendos me aktgjykim në lidhje me kërkesëpadinë e në të cilin rast nxirret një vendim meritore në formë të aktgjykimit dhe jo në formë të aktvendimit ngase me aktvendim vetëm përjashtimisht vendoset për çështje meritore dhe rastet e tilla janë të përcaktuara në dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Duke u nisur nga të cekurat si më lartë, gjykata e Apelit nuk e ka të kuartë se gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e ankimuar a ka vendosur meritorisht në lidhje me kërkesë padinë e paditësit, pasi që e njëjta ka vendosur me aktvendimi gjë që është në kundërshtim me nenin 142 të LPK-së, apo ka vendosur në mënyrë procedurale për padinë e paditësit. andaj, në këtë kuptim gjykata e apelit nuk e ka të kuartë se gjykata e shkallës së parë, kërkesë padinë e paditësit (padinë) e ka refuzuar për shkak të mungesës së legjitimitetit të palëve në procedurë apo në mungesë të interesit juridik, pasi që nëse në se konstatohet se palëve i mungon legjitimiteti për të qenë palë në këtë procedurë, të njëjtën padi nuk mund të refuzon për shkak të interesit juridik e që në rastin konkret paditësi ka interes juridik në këtë çështje kontestimore, pasi që kërkesa e palës paditëse ndryshon nga gjendja faktike e cekur në kontratën e shitblerjes.

Duke marrë për bazë shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore të cekura si më lartë, vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike ka rezultuar edhe me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, përkatësisht gjykata e shkallës së parë në mënyrë të gabuar ka zbatuar dispozitën materiale me rastin e vendosjes lidhur me kërkesëpadinë kur e njëjta aktvendimin e saj e ka mbështetur në dispozitën e nenit 391, pika e) e cila përcakton se “ Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se

konstaton se:... për objektin e kontestit është lidhur ujdia gjyqësore, se paditësi në gjykatë ka hequr dorë nga kërkesëpadia, se nuk ekziston interesi juridik i paditësit për padi vërtetimi”. Kjo dispozitë në mënyrë të qartë dhe të saktë përcakton se me rastin e shqyrtimit paraprak me aktvendim e hedh poshtë padinë, ndërsa në rastin konkret gjykata e shkallës së parë, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor me aktvendim e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit për shkak të mungesës së interesit juridik dhe për shkak të mungesës së legjitimitetit të palëve.

Nga të gjitha arsyet e cekura më lartë, Gjykata e Apelit e udhëzon gjykatën e shkallës së parë, që me rastin e marrjes së lëndës në rishqyrtim dhe rivendosje, të ndërmarrë veprimet e duhura për të eliminuar shkeljet e evidentuara si në arsyetim të këtij aktvendimi, në pajtim me dispozitat imperative ligjore, duke u kujdesur njëkohësisht edhe për çështjet tjera nga të cilat varet lejueshmëria e procesit gjyqësor si dhe të vlerësoj se në rastin konkret a janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit në bazë të pohimit, varësisht nga vlerësimi i këtyre kushteve, të ndërmarrë veprimet e nevojshme për të vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike dhe krejt në fund të merr vendim meritator për çështjen konkrete, por gjithmonë vendimi i përpiluar të jetë në harmoni me dispozitat ligjore dhe specifikisht t’i ketë parasysh kërkesat ligjore që rrjedhin nga dispozitat e nenit 160 të LPK-së (sidomos dispozitivi të hartohet në përputhje me parag.3 të nenit 160 të LPK-së, ndërsa arsyetimin e aktgjykimit ta hartojë në përputhje me parag.4 dhe 5 të LPK-së, ashtu që duhet të jepet arsyetim i mjaftueshëm për rrethanat dhe shkaqet e refuzimit apo aprovimit të kërkesëpadi së paditësit), ashtu që pas administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse, të vërtetojë gjendjen faktike, bazën juridike të kërkesëpadi së dhe në fund të vendosë për kërkesëpadinë e paditësit në bazë të ligjit.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga nenet 194 dhe 195, paragrafi 1, pika (c), të LPK-së, Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.1903/2021, më datë 22.04.2024.

Kryetari i kolegjit - gjyqtari,
Besnik Bislimaj, d.v